

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6725
E premte, 7 tetor 2022
çmimi 0.40 €

Specialja refuzon 46 persona që u paraqitën viktima të UÇK-së



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

GËRHXHALIU: NË MUNGESË TË KONFRONTIMIT ME OPOZITËN, ASHPËRSONHET KONFLIKTI ME SINDIKATAT



Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhalii, ka thënë se kohën e fundit në Kosovë është duke munguar një dialog i mirëfilltë publiko privat. Sipas tij, nuk po shohim gatishmëri për të debatuar në mënyrë të

argumentuar për problemet e krijuara. "Për fat të keq, çdo gjë është politizuar", ka thënë Gërxhalii, duke shtuar se në mungesë të konfrontimit me opozitën, qeveria ka ashpërsuar konfliktin me sindikatat

AKTUALE



FRANCEZJA ANNIE ERNAUX FITON
ÇMIMIN NOBEL PËR LETËRSI F.2

NË PRISHTINË MBAHET SEMINARI I
102-TË ROSE-ROTH I ASAMBLESË
PARLAMENTARE TË NATO-S F.2

VELIAJ E PRET NË TAKIM SMAJL
LATIFIN, PAJTOHEN PËR
BASHKËPUNIM TË DYANSHËM F.4

EKONOMI



QEVERIA SUBVENCIONON
PAJISJET EFIÇIENTE
PËR NGROHJE PËR QYTETARË F.8

OPERIMET NË TREPÇË VIHEN NË
RREZIK F.8

SPORT



SEKRETARI GJENERAL I FIBA BOTËS:
FBK-JA ËSHTË NDËR FEDERATAT
MË AKTIVE F.10



RRETH 1 500 ARMË ILEGALE KONFISKOHEN ÇDO VIT NË KOSOVË



OPOZITA SOLIDARIZOHET ME MËSIMDHËNËSIT, LËSHON MBLEDHJEN E KRYESISË SË KUVENDIT

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Francezja Annie Ernaux fiton çmimin Nobel për letërsi



PARIS, 6 TETOR - Shkrimtarja franceze Annie Ernaux ka fituar çmimin Nobel për letërsi. Ernaux, 82 vjeçe, u citua për "guximin dhe mprehtësinë me të cilën ajo zbulon rrënjët, largimet dhe kufizimet kolektive të kujtesës personale", tha komiteti Nobel. Fituesi u shpall nga Mats Malm, sekretar i përhershëm i Akademisë Suedeze. Më 5 tetor çmimi Nobel për

kimi u është ndarë dy amerikanëve, Carolyn Bertozzi dhe Barry Sharpless, si dhe danezit Morten Meldal, për krijimin e një forme më funksionale të kimisë. Një ditë më herët, më 4 tetor, çmimi Nobel për fizikë u është ndarë tre shkencëtarëve: francezit Alain Aspect, amerikanit John Clauser dhe austriakut Anton Zeilinger për zbulimet e tyre në fushën e

mekanikës kuantike. Ndërsa më 3 tetor, shkencëtari suedez Svante Paabo fitoi çmimin Nobel për mjekësi për shkak të zbulimeve të lidhura me evolucionin njerëzor. Çmimi Nobel për paqe do të shpallet të premten dhe çmimi Nobel për ekonomi të hënën. Çmimet kanë vlerën e 900.357 dollarëve amerikanë dhe do të shpërndahen më 10 dhjetor.

Rusia thotë se është e "përkushtuar" të shmangë një luftë bërthamore

MOSKË, 6 TETOR - Rusia tha se është "e përkushtuar plotësisht" për të shmangur një konflikt bërthamor. Kjo deklaratë vjen teksa shqetësimet në botë u rritën pas disa deklaratave të bëra së fundmi nga Kremli, që linin të kuptohej se armët bërthamore ishin opsion nëse lufta në Ukrainë do të përshkallëzohej. "Federata Ruse plotësisht i përmbahet parimit që të mos lejojë që një luftë bërthamore të nisë... Ne kemi thënë dhe e konfirmojmë këtë

çdoherë. Nuk do të kishte fitues në një luftë të tillë dhe një gjë e tillë kurrë nuk duhet të ndodhë", tha zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme ruse, Maria Zakharova, më 6 tetor. Presidenti rus Vladimir Putin dhe zyrtarë të tjerë rusë kanë thënë në ditët e fundit se ata nuk po bëjnë "blof" me deklaratat e tyre se Moska "ka të drejtë t'i përdorë të gjitha mjetet ushtarake për ta mbrojtur territorin e saj", përfshirë "edhe rajonet që janë bashkuar së fundmi".

Shumë në Perëndim i kanë kuptuar këto deklaratat se Rusia nuk e përjashton mundësinë e përdorimit të armëve bërthamore. Sipas doktrinës së ushtrisë ruse, shteti ka të drejtë të përdorë armë bërthamore në rast se ka rrezik për ekzistencën e shtetit. Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt dhe muajin e fundit ka shpallur një mobilizim të "pjesëshëm ushtarak" pas humbjeve të pësuar nga forcat e Kievit.



Suedia gjen dëshmi për shpërthime në tubacionet ruse në Baltik

STOKHOLM, 6 TETOR - Shërbimi i Sigurisë i Suedisë tha se hetimet në tubacionet Rrjedha Veriore 1 dhe 2, që sjellin gaz nga Rusia në Evropë, kanë forcuar dyshimet për një "sabotim të madh" që përfshin shpërthime. Autoritetet suedeze dhe daneze kanë hetuar katër rrjedhje nga gazsjellësit në Suedi dhe Danimarkë në Detin Baltik qëkur ato u zbuluan javën e kaluar. Evropa, e cila po përballet me krizë energjetike pas pushtimit rus të Ukrainës, po heton se çfarë shkaktoi rrjedhjet, teksa Moska po tenton që t'ia lë fajin Perëndimit, duke sugjeruar se Shtetet e Bashkuara përfitojnë nga kjo situatë. Uashingtoni mbron çdo përfshirje dhe tha javën e kaluar se nuk ishte në gjendje ta



inspektonte pjesën e dëmtuar të tubacionit për shkak të kufizimeve të vendosura nga autoritetet në Danimarkë dhe Suedi, që kanë bllokuar zonën ku janë ndodhur rrjedhjet. "Pasi ka përfunduar hetimi në vendin e

ngjarjes, Shërbimi i Sigurisë së Suedisë erdhi në përfundim se ka pasur shpërthime në Rrjedhën Veriore 1 dhe 2 në zonën ekonomike suedeze", tha ky shërbim përmes një deklaratë. Shërbimi i Sigurisë së Suedisë tha

se ka dëme të mëdha në gazsjellësin dhe se kanë arritur të marrin material nga vendi i ngjarjes, i cili tani do të analizohet. Të dhënat "kanë forcuar dyshimin e një sabotimi të madh", thanë nga ky shërbim. Prokuroria e Suedisë tha përmes një deklaratë se zona ku gazi ka rrjedhur për një javë nuk është më e bllokuar për qarkullim. Rusia tha të enjten se është informuar përmes kanaleve zyrtare se nuk mund të bëhet pjesë e hetimit. "Deri më tani nuk ka plane që t'i kërkohet Rusisë që t'u bashkohet hetimeve", tha zëdhënësi i Kremilit, Dmitry Peskov, duke shtuar se pa pjesëmarrjen e Moskës nuk mund të kryhet një hetim objektiv. Të hënën prokurorët bllokuan

zonën ku ndodhën rrjedhjet në mënyrë që të kryejë hetimin nga Rojet Bregdetare dhe Marina. Bashkimi Evropian dhe NATO kanë thënë se katër rrjedhjet janë sabotim. Moska kishte ulur furnizimet me gaz për në Evropë përmes gazsjellësit Rrjedha Veriore 1. Ndërkaq, në gusht ndërpreu të gjitha furnizimet nga ky tubacion, duke thënë se sanksionet perëndimore kanë shkaktuar probleme teknike. Gazsjellësi Rrjedha Veriore 2 është i kompletuar, por Gjermania hoqi dorë nga plani për ta funksionalizuar këtë tubacion pak ditë para se Rusia ta niste pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt. Megjithatë, të dy këta gazsjellës kanë gaz nën presion.

Ish-polici vrau 37 persona në një kopsht fëmijësh në Tajlandë

BANGKOK, 6 TETOR - Një ish-polici ka qëlluar në masë në një kopsht fëmijësh në Tajlandë më 6 tetor dhe ka vrarë 37 persona. Më pas, siç raportuan mediet lokale, sulmuesi i

armatosur kreu vetëvrasje. Në mesin e viktimave janë 24 fëmijë, ka thënë policia në një njoftim. Të shtënat në masë janë të rralla në Tajlandë, ndonëse

shkalla e posedimit të armëve është e lartë në krahasim me disa vende të tjera të rajonit dhe armët ilegale janë të zakonshme. Dy vjet më parë, një ushtar i

zemëruar, për shkak të një kontesti rreth një marrëveshjeje pronësie, në katër lokacione vrau të paktën 29 persona dhe plagosi 57 duke qëlluar me armë zjarri.



Specialja refuzon 46 persona që u paraqitën viktima të UÇK-së

HAGË, 6 TETOR - Zyra për Pjesëmarrjen e Viktimave në kuadër të Dhomave të Specializuara të Hagës ka dorëzuar raportin e shtatë me aplikimet e personave që pretendojnë të jenë viktima të UÇK-së në rastin e krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Në raportin e kësaj zyre shihet se 46 persona kanë aplikuar për statusin e viktimës pjesëmarrëse në gjykimin kundër krerëve të luftës. Këta aplikantë kanë pretenduar se anëtarë të familjes së tyre të

ngushtë janë kidnapuar nga ushtarë të UÇK-së, zhdukur, e disa prej tyre më vonë janë gjetur të vrarë.

Sidoqoftë, asnjë nga 46 personat që po pretendojnë të jenë viktima të UÇK-së nuk kanë arritur të dëshmojnë se anëtarët e tyre të familjes që ata pretendojnë se janë marrë nga anëtarë të UÇK-së janë dërguar në ndonjë prej "burgjeve" për të cilat prokuroria e gjykatës i akuzon Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin. Dhe kjo është

arsyeja kryesore pse Zyra për Pjesëmarrjen e Viktimave i ka rekomanduar gjyqtarit të procedurës paraprake që t'i hedhë poshtë të 46 aplikimet. Kjo zyrë ka kërkuar nga gjyqtari i procedurës paraprake të veprojë siç ka bërë më herët kur ka refuzuar aplikimet e viktimave të pretenduara dhe t'u përmbahet rregullave të konfidencialitetit.

Kësisoj, ky institucion brenda Speciales ka kërkuar që emrat e aplikuesve mos të shpërndahen në publik.



Në Prishtinë mbahet Seminari i 102-të Rose-Roth i Asamblesë Parlamentare të NATO-s

PRISHTINË, 6 TETOR - Më 8 deri më 10 tetor në Prishtinë do të mbahet Seminari i 102-të Rose-Roth i Asamblesë Parlamentare të NATO-s, me temën "Integrimi euroatlantik i Ballkanit Perëndimor: sfidat e zgjatura, realitetet e reja dhe perspektivat e ardhshme", në të cilin pritet të jenë më shumë se 100 pjesëmarrës, duke përfshirë deputetë nga vende anëtare të NATO-s dhe vendet partnere.

Në takimin treditor do të diskutohet për sfidat dhe perspektivën e ardhshme për Ballkanin Perëndimor në një mjedis të ndryshueshëm të sigurisë evropiane, mbështetjen e NATO-s për



NATO
PARLIAMENTARY ASSEMBLY
ASSEMBLEE PARLEMENTAIRE
DE L'OTAN

paqen dhe stabilitetin në rajon, për qeverisjen dhe reformën e sektorit të sigurisë në Kosovë dhe mbikëqyrjen parlamentare mbi institucionet e sigurisë në Kosovë.

Ligjvënës të NATO-s, përfaqësues të institucioneve të Kosovës, si dhe të institucioneve e organizatave të ndryshme ndërkombëtare, do të diskutojnë për perspektivën e

integritit evropian të Kosovës dhe përparimin e deritashëm, për situatën ekonomike në rajon pas Covid-19, për rolin e të rinjve për ndërtimin e shoqërive të qëndrueshme, për sigurinë dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor, zhvillimet politike dhe të sigurisë në Bosnjë-Hercegovinë, implikimet e luftës në Ukrainë për Ballkanin Perëndimor, shtrirjen dhe implikimet e ndikimit të Rusisë në Ballkanin Perëndimor, pastaj për kontributin e grave për paqen dhe sigurinë rajonale, pjesëmarrjen politike të tyre në Kosovë, si dhe forcimin e sundimit të ligjit e luftimin e

korupsionit.

Seminari i 102-të Rose-Roth organizohet në bashkëpunim me Kuvendin e Kosovës, nën udhëheqjen e kryetarit të delegacionit të Kuvendit të Kosovës në AP të NATO-s, deputetit Driton Hyseni, si dhe me përkrahjen e Qeverisë së Zvicrës e të Qendrës së Gjenezës për Qeverisje të Sektorit të Sigurisë (DCAF), së bashku me Komisionin për Ekonomi dhe Siguri.

Qëllimi kryesor i Seminareve Rose-Roth është lehtësimi i dialogut që lidhet me çështjet e sigurisë rajonale, në mesin e ligjvënësve të NATO-s dhe vendeve partnere.

Babai i Thaçit merr pjesë në shënimin e 300-vjetorit të xhamisë së Burojës



SKENDERAJ, 6 TETOR - Në fshatin Burojë të Skenderajt, vendlindjen e ish-presidentit Hashim Thaçi është shënuar 300-vjetori i ndërtimit të xhamisë së këtij fshati. Në

këtë përvjetor ka marrë pjesë edhe babai i Thaçit, Haxhiu. Lajmin e ka bërë me dije nënkryetari i Skenderajt, Sami Lushtaku, i cili ka publikuar në "Facebook" disa

foto nga ky përvjetor. "Në Burojën e presidentit Hashim Thaçi, në 300-vjetorin e ndërtimit të xhamisë së fshatit, një objekt shumë i veçantë i identitetit fetar, i cili

ka shërbyer edhe si institucion edukativo-arsimor, duke kontribuar në ruajtjen e identitetit tonë kombëtar, përmes hoxhallarëve të zotë si Mulla

Ilaz Buroja e Avdyl Krasniqi, që me përkushtimin më të madh i shërbyen komunitetit të kësaj zone dhe atdheut sa herë kishte nevojë!", ka shkruar Krasniqi.



Gërxhaliu: Në mungesë të konfrontimit me opozitën, ashpërsohet konflikti me sindikatat

Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, ka thënë se kohën e fundit në Kosovë është duke munguar një dialog i mirëfilltë publiko-privat. Sipas tij, nuk po shohim gatishmëri për të debatuar në mënyrë të argumentuar për problemet e krijuara. “Për fat të keq, çdo gjë është politizuar”, ka thënë Gërxhaliu, duke shtuar se në mungesë të konfrontimit me opozitën, qeveria ka ashpërsuar konfliktin me sindikatat

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHINË, 6 TETOR - Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, ka komentuar situatën e fundit në vend në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) si dhe Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK). Në një bisedë për gazetën “Epoka e re”, Gërxhaliu ka thënë se këto raporte mes qeverisë dhe sindikatave janë duke dëmtuar Kosovën në dimensione të ndryshme. “Raportet e krijuara në mes të Qeverisë së Kosovës dhe sindikatave janë duke dëmtuar Kosovën në fusha të shumta. Shumë herë analizohet një raport

i tillë dhe një situatë e krijuar në aspektin politik dhe të arsimit. Askush nuk e analizon aspektin ekonomik dhe dëmet që shkaktohen në aspektin emocional të nxënësit dhe të mësimit. Duhet të kuptohet se arsimit është arma më e fuqishme e një shteti”, ka thënë ai. Gërxhaliu ka theksuar se nëse vazhdohet me një konfrontim të tillë do të dëmtohet ardhmëria e arsimit. “Pra, do të ngufatet ardhmëria dhe perspektiva e Republikës së Kosovës. Prandaj, po dëshmojmë se në Kosovë mungon një dialog i mirëfilltë publiko-privat, sepse nuk ka gatishmëri për të debatuar në mënyrë të argumentuar. Për fat të keq, çdo gjë është politizuar”, ka thënë ai.

Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës ka theksuar se në këtë drejtim qeveria aktuale po e ndien mungesën e një konfrontimi me një opozitë të mirëfilltë politike. “Opozita për momentin është inegzistente dhe është hapur front konfrontimi me sindikatat. Një dialog - konfrontim i tillë - nuk i bën nder Kosovës dhe ardhmërisë së saj. Në veçanti kam drojën se po denigrohet vlera e të qenit mësimit dhe profesor në Kosovë. Duhet të kuptohet se themelet e shtetit i ka vënë arsimit. Para luftës dhe gjatë luftës mësimit kanë qenë ata të cilët e kanë mbajtur arsimin mbi supet e veta dhe kanë rrezikuar veten për vite të tëra vetëm për ta ngritur edukimin. Nëse e bëjmë një analizë, punëtorët e arsimit më së shumti janë rrahur nga forcat policore në Kosovë gjatë okupimit, prandaj arsimit e meriton një dialog të mirëfilltë dhe nuk duhet që të tentohet të zëvendësohet roli i sindikatave në mungesën e opozitës në Kosovë”, është shprehur Gërxhaliu. Ai ka thënë se në këtë rast është duke u goditur shtresa e mesme e qytetarëve. “Në një shtet ku varrosjet dhe shkatërrohet shtresa

e mesme, atëherë kemi të bëjmë me një situatë alarmante. Dhe është duke u goditur më së shumti gjinia femërore, sepse nëse janë diku 70 deri në 80 për qind femra në arsim, atëherë po shkelen shumë konventa dhe premtime. Dhe çështje tjetër është se shumë prej mësimit janë në kredi. Paramendojeni si e ndiejnë ata veten kur do të hyjnë në lista të zeza të bankave në kohën kur inflacioni në Kosovë është 19.2 për qind duke u bazuar në raportet e Fondit Monetar të Bankës Botërore. Nuk bën të luhet me emocionet e mësimit. Si e ndien veten nxënësi në shkollë kur mësimit nuk e ka marrë pagën. Çfarë performance mund të presim prej mësimit përballë nxënësve”, ka deklaruar Gërxhaliu. Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, ka theksuar se është obligues për hir të aspektit moral, kombëtar dhe për hir të rëndësisë së arsimit që mësimit t'i marrin sa më shpejt pagat. “Sindikatat nuk e kanë të drejtën të shndërrohen në opozitë politike, sepse ato janë zëri i arsyes për t'i mbrojtur interesat e mësimit dhe jo të

shndërrohen në parti politike. Gabimi më i madh që nuk duhet të promovohet ka të bëjë me atë se nuk duhet të ketë zëvendësim të orëve të humbura. Prandaj bëj thirrje për maturi në deklarata”, është shprehur ai, duke shtuar se duhet motivim për t'i ulur këto raporte konfrontuese. “Të gjendet modaliteti për avancimin e arsimit. Çdo marrëveshje në mes të Sindikatës së Arsimit dhe qeverisë mos të konsiderohet fituese për njërin palë. Në këtë rast fiton ardhmëria. Është koha kur duhet reflektim dhe jo politizim. Pra, edhe një herë po ritheksoj se nuk duhet që të trajtohen sindikatat si opozitë, por të ketë unitet dhe të dominojë arsyeja. Kosova është duke u dëmtuar në fusha të shumta, në veçanti kur në këtë kohë na pret një dialog i ashpër dhe një agresivitet i Serbisë ndaj Kosovës. Në këtë kohë kur kriza ekonomike dhe sociale është në rritje e sipër, dhe në këtë kohë kur shumë vende bëjnë çmos për ta mbështetur arsimin, ne dëshirojmë ta dëmtojmë. Andaj është koha për veprim dhe duhet të mendojmë drejt ardhmërisë”, ka thënë Safet Gërxhaliu, ekspert i ekonomisë.

Rreth 1 500 armë ilegale konfiskohen çdo vit në Kosovë

PRISHTINË, 6 TETOR - “U plagos nga një plumb qorr në natën e ndërrimit të viteve, vdes Shpresa Kastrati”, “Një person lëndohet nga plumbi qorr në oborrin e tij në Deçan”, janë mbishkrimet në ekspozitën që është lansuar bashkë me hapjen e fushatës “Festo me zemër, jo me armë”.

Kjo fushatë organizohet nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Kjo fushatë synon ngritjen e vetëdijes për rrezikun e posedimit dhe keqpërdorimit të armëve të vogla dhe të lehta.

Të enjten është thënë se çdo vit Policia e Kosovës konfiskon rreth

1 500 armë ilegale. Këto të fundit po konsiderohen shkaktarët kryesorë për pjesën më të madhe të vrasjeve dhe të krimeve në Kosovë.

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Blerim Gashani, ka thënë se edhe pas përfundimit të luftës në Kosovë, përdorimi i armëve ilegale vazhdon të mbetet shqetësim për institucionet dhe shoqërinë. “Armët në posedim të paligjshëm nga qytetarët që qarkullojnë në Kosovë janë shkaktarët kryesorë për pjesën dërrmuese të vrasjeve dhe të një sërë krimesh që kanë ndodhur, qofshin ato të dhunës në familje, grabitjeve dhe të krimeve të tjera.

Në aspektin e parandalimit, përveç MPB-së, edhe aktorët e tjerë duhet ta luajnë rolin në aspektin e vetëdijesimit për pasojat që vijnë nga mbajtja e me të gjitha agjencitë e saj, edhe aktorët e tjerë duhet ta luajnë rolin e tyre në aspektin e vetëdijesimit apo sensibilizimit të shoqërisë lidhur me pasojat që mund të vijnë nga posedimi i paligjshëm dhe veprimeve të kundërligjshme në përgjithësi”, ka thënë Gashani.

Në lansimin e fushatës “Festo me zemër, jo me armë”, Gashani ka shtuar se kapacitetet e Kosovës në fushën e kontrollit janë duke u rritur.

Ndërsa Niels Knudsen nga

UNDP-ja ka thënë se pothuajse çdo ditë po shënohen incidente që vijnë nga përdorimi i armëve. Sipas tij, çdo plumb i shkrepur ka një cak dhe kështu po shkaktohen edhe dëme në familje. “Qarkullimi i këtyre armëve janë ata që shkaktojnë dhunën dhe pabarazinë dhe përmendim këtë si indikator global, si këto armë qarkullojnë dhe numri i tyre, edhe pse është qarkulluar, ato prapë shfrytëzohen në vepra të dhunës, për shkak që siguria ka një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën apo në sigurinë e qytetarëve dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të këtij shteti. Këto janë kushtet fundamentale për

një prosperitet të një shoqërie. Diku rreth 150 mijë armë të paligjshme qëndrojnë në duart e popullit. Zëvendësministri e përmendi se sa përpjekje po investohen që të merren ato dhe hequr nga njerëzit, prapë ekzistojnë atje. Ato paraqesin një kërcënim për familjen dhe popullatën. Duke marrë parasysh që veprat penale që po ndodhin, shumica prej tyre kanë të bëjnë përmes përdorimit të armëve. Shohim edhe në shtëpi që dhuna familjare kurdo që përshkallëzohet, në shumicën e rasteve dhe gati çdo herë nëse gratë janë viktime. Ajo armë që përdoret është ilegale”, ka deklaruar Knudsen.



Veliaj e pret në takim Smajl Latifin, pajtohen për bashkëpunim të dyanshëm

TIRANË, 6 TETOR - Kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, është pritur në takim nga kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj. Latifi ka treguar se në këtë takim u pajtuan për bashkëpunim institucional në fushën e bujqësisë, ekonomisë, turizmit, rinisë e sportit, si

dhe në zhvillimin e agro-turizmit. “Mundësi të jashtëzakonshme këto, me dobi të drejtpërdrejta mes nesh. Ndihe mi jashtëzakonisht mirë në kryeqytetin i cili, falë punës së z. Veliaj, është shndërruar në një model edhe për kryeqendrat e mëdha

rajonale dhe evropiane, po ashtu edhe më të nderuar ndihemi që tashmë edhe komuna e Rahovecit është pjesë e familjes së madhe të Unionit të Bashkive në rajon”, ka shkruar Latifi në “Facebook”. Latifi në këtë vizitë ishte i shoqëruar edhe nga bashkëpunëtorët.



Totaj nënshkruan memorandum bashkëpunimi me “Liria” dhe “Handikos Prizren”

PRIZREN, 6 TETOR - Tetori është muaji i ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit për personat me aftësi të kufizuara dhe në kuadër të aktiviteteve të këtij muaji, kryetari Shaqir Totaj ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi në mes të komunës së Prizrenit, shoqatës “Liria” në Suedi dhe OJQ “Handikos Prizren”. Kjo marrëveshje është bashkëfinancim i projektit: Donacion (pajisje) nga OJQ

“Liria” nga Suedia, për personat me nevoja të veçanta të OJQ “Handikos - Prizren”, financimi i transportit të pajisjeve nga komuna e Prizrenit dhe menaxhimi i tyre nga “Handikos-Prizren”.

Vlera e këtij projekti është rreth 150 000 euro, ndërsa pajisjet do të shfrytëzohen nga të gjithë personat që kanë nevojë në komunën e Prizrenit.



Hamza pret në takim ambasadorin e ri të Finlandës, diskutojnë për lidhjet ekonomike

MITROVICË, 6 TETOR - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, i shoqëruar nga drejtoresha e DKRS-së, Valdete Idrizi, ka pritur në takim ambasadorin e ri të Finlandës në Kosovë, Matti Nissinen, të cilin e ka uruar për marrjen e detyrës. Në këtë takim është diskutuar për çështje të ndryshme, konkretisht për fushën e arsimit, kulturës, si dhe për mundësitë e nxitjes së zhvillimit ekonomik në qytetin e

Mitrovicës. Kryetari Hamza i ka shprehur mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme shtetit të Finlandës dhënë Republikës së Kosovës, ndërsa ambasadori Nissinen e ka falënderuar për mikpritjen që i është bërë gjatë vizitës së tij në Mitrovicë. Në fund të dyja palët janë pajtuar për ta thelluar bashkëpunimin dhe për t'i forcuar lidhjet ekonomike ndërmjet dy vendeve.

Tahiri në Dardanë: Kjo komunë ka nevojë për më shumë mbështetje në investime kapitale

DARDANË, 6 TETOR - Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, së bashku me kolegët e grupit parlamentar, kanë vizituar nënkryetarin e komunës së Dardanës, Faton Jakupi. “Aktiviteti i Aleancës ndër vite në këtë qytet është shembull i një qeverisje të mirë. Leadershipti i treguar i Fatonit, Aleancën e ka faktorizuar si njëri ndër partitë kryesore në Kamenicë”, ka shkruar Tahiri në “Facebook”.

Ai ka thënë se Dardana, si një komunë me kapacitete të mëdha në bujqësi e turizëm, ka nevojë për më shumë mbështetje në investime kapitale nga pushteti qendror, në veçanti rreth zhvillimit ekonomik lokal. “I uruam sukses të mëtejme në qeverisje dhe ia ofruam mbështetjen tonë si deputetë të Kuvendit të Kosovës në çështjet që janë në të mirë të qytetarëve të komunës së Kamenicës”, ka shkruar Tahiri.



Vendosen kamerat e sigurisë në qytetin e Deçanit

Deçan, 6 tetor - Në kuadër të investimeve dhe projekteve komunale, ka filluar realizimi i projektit për instalimin e kamerave të sigurisë në qytetin e Deçanit.

Kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë se ky projekt garanton më shumë siguri për jetën, pronën dhe qytetarët të cilët banojnë apo kalojnë në këtë zonë dhe, po

ashtu, ndihmon në parandalimin e veprave penale dhe kundërvajtjeve, meqë në këtë zonë ka frekuentim më të madh të qytetarëve.



Vetëvendosja hap shkollë politike për aktivistët

PRISHTINË, 6 TETOR - Sekretariati për Emancipim Politik në Lëvizjen Vetëvendosje ka mbajtur sesionin hapës për nivelin teorik të shkollës politike. Aktivistët Pavjo Gjini, Mrika Limani Myrtaj, Liridona Kelani dhe Hazir Asllani mirëpritën ndjekësit e shkollës për këtë vit, ka njoftuar Lëvizja Vetëvendosje.


Sipas këtij njoftimi, Pavjo Gjini bisedoi për esencën e aktivizmit të zbërthyer përmes shkollës politike, duke vënë theksin te raportet ndërmjet teorisë dhe praktikës dhe natyra praktike e teorisë në përditshmëri. "Ai foli për shkollën si kuvend përmes të cilit aktivistët do të mund të diskutojnë e shkëmbejnë ide në shërbim të pajimit me mendim kritik dhe qasjen për ta lëkundur dogmatiken kurdoherë ajo synon

të zë rrënjë, në këtë formë duke mundësuar emancipimin në vetvete. Ndërkaq, Mrika Limani Myrtaj diskutoi shkurtimisht për paramendimin e shkollës politike si tërësi për demitizim të teorisë dhe më pas i informoi ndjekësit për çështjet praktike të ndjekjes së shkollës politike", ka njoftuar LV-ja.

Sipas Lëvizjes Vetëvendosje, ky nivel i shkollës do të zgjasë deri në verën e vitit që vjen dhe do të përmbajë pesë lëndë të ndryshme. "Aktivistet e aktivistët nga qytete të Kosovës, Shqipërisë dhe nga diaspora, do ta kenë rastin të ndjekin ligjërata dhe të marrin pjesë në diskutime bashkë me ligjërues të shumtë që vijnë nga fusha e profesioneve të ndryshme", ka njoftuar Lëvizja Vetëvendosje.



Oda e Hotelerisë: 30 për qind e bizneseve në Kosovë rrezikojnë të mbyllen



PRISHTINË, 6 TETOR - Oda e Hotelerisë dhe Turizmit (OHT) ka alarmuar të enjten se 30 për qind e bizneseve në Kosovë rrezikojnë të mbyllen. Kështu ka bërë me dije Oda e Hotelerisë dhe Turizmit (OHT) pas një takimi që kryetari i kësaj ode, Hysen Sogojeva, ka zhvilluar me kryetarët e njësjive rajonale. "Në këtë takim u diskutua për shumë çështje dhe problematika me të cilat po ballafaqohen bizneset në tërë Kosovën. Kryetarët e njësjive rajonale janë shprehur shumë të

shqetësuar për gjendjen aktuale me të cilën po ballafaqohen bizneset e sidomos me ngritjen e çmimeve duke e argumentuar këtë me faktin se nga janari kostoja e mallit është ngritur 42 për qind e duke ia shtuar kësaj edhe problemet me të cilat bizneset do të përballen gjatë dimrit për shkak të paralajmërimeve për krizë energjetike. Qeveria ka paralajmëruar që na pret një dimër i vështirë, prandaj OHT-ja kërkon që të gjendet mënyra që këto biznese të ndihmohen,

përndryshe së paku 30 për qind e tyre rrezikojnë të mbyllen. Qeveria në vend se të marrë vendime që e rëndojnë edhe më shumë gjendjen e bizneseve, duhet që së bashku me OHT-në dhe odat e tjera të gjejë mënyra për përkrahjen e tyre që të mbijetojnë e të mos mbyllen. OHT-ja do të vazhdojë të jetë zë dhe përfaqësues i bizneseve para të gjitha institucioneve dhe mekanizmave të tjerë", ka njoftuar Oda e Hotelerisë dhe Turizmit (OHT).

Opozita solidarizohet me mësimdhënësit, lëshon mbledhjen e kryesisë së Kuvendit

PRISHTINË, 6 TETOR - Partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, të enjten e kanë lëshuar mbledhjen e kryesisë së Kuvendit të Kosovës në shenjë revolte për mosekzekutimin e pagave për sektorin e arsimit.

Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Arben Gashi, ka thënë se në shenjë pakënaqësie për mosekzekutimin e pagave nga Qeveria e Kosovës për sektorin e arsimit, ka lëshuar mbledhjen e kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Gashi në një konferencë për medie ka theksuar se Qeveria e Kosovës me sjelljen e vet me tendencë

autoritare ka shkelur hierarkinë kushtetuese. Ai tha se Qeveria e Kosovës në mënyrë arbitrare është duke pamundësuar marrjen e pagave të 25 mijë familjeve në Kosovë.

Edhe shefi i grupit parlamentar nga radhët e PDK-së, Abelard Tahiri, ka thënë se në shenjë revolte ka lëshuar mbledhjen e kryesisë së Kuvendit të Kosovës, pasi Qeveria e Kosovës nuk i ka ekzekutuar pagat për mësimdhënësit. Ai ka thënë se mosekzekutimi i pagave për mësimdhënësit është një vendim i paligjshëm si dhe e quajti një vendi arrogant të ministrit të Financave, Hekuran Murati.



Për gjashtë muaj në Klinikën e Neonatologjisë janë trajtuar 4 446 foshnja



PRISHTINË, 6 TETOR - Në Klinikën e Neonatologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, në gjashtë muajt e parë të këtij viti, janë trajtuar 4 446 foshnja, të cilat janë lindur në Klinikën e Gjinekologjisë.

Në këtë klinikë, gjatë periudhës janar-qershor, për trajtim të mëtutjeshëm mjekësor, janë pranuar edhe 290 foshnja nga jashtë. Vdekshmëria në Neonatologji, për pranimet

nga Gjinekologjia, sipas të dhënave të raportit, ka rënë në 12.5 promila, kurse nga jashtë në 3.1 %. Foshnja premature të lindura në Klinikën e Gjinekologjisë janë 382, ndërsa nga jashtë 27.

Operimet në Trepçë vihen në rrezik



PRISHTINË, 6 TETOR - Gjiganti metalurgjik Trepça në Kosovë rrezikon t'i ndërpresë punimet si pasojë e rritjes së çmimit të energjisë elektrike, paralajmërojnë udhëheqës të ndërmarrjes. Kosova është prekur nga kjo krizë globale, që është shkaktuar fillimisht nga pandemia e koronavirusit dhe është përkeqësuar me nisjen e luftës ruse në Ukrainë. "Në shtator, faturën e energjisë e kemi pasur 917 mijë euro. Në kushte normale, para kësaj krize me energji, ishte deri në 90 mijë euro", thotë Behxhet Vinarci, drejtor i minierës me flotacion, Trepça - Stantërg, e cila ndodhet në rajonin e Mitrovicës. Trepça është shoqëri aksionare: 80 për qind e aksioneve janë të Qeverisë së Kosovës, kurse 20 për qind janë të punonjësve të

kësaj ndërmarrjeje. Produktet kryesore që prodhohen atje janë koncentratet e plumbit dhe zinkut me përmbajtje të argjendit, arit dhe elementeve të tjera. Miniera e Stantërgut e ndërmarrjes Trepça është vendburimi kryesor i nxjerrjes së xehes. Në vit prej aty nxirren mbi 180 mijë tonë xehë. Nga miniera tjetër, ajo e Artanës, nxirren rreth 40 mijë tonë xehë në vit. Këto janë dy nga minierat më të mëdha funksionale të ndërmarrjes Trepça. Tregu, ku aktualisht operon Trepça, është ai evropian. Koncentrati i plumbit dhe ai i zinkut eksportohen në Evropë përmes tenderëve publikë ndërkombëtarë. Operatori i fundit që ka fituar

tenderin në vitin 2021 është një kompani nga Londra. Të hyrat nga shitja e koncentrateve të plumbit dhe zinkut në vitin 2021 kanë qenë mbi 13 milionë euro. Gjatë vitit 2022, sipas planit të biznesit, është planifikuar të nxirren mbi 200 mijë tonë xehë dhe të hyrat të arrijnë në 18 milionë euro, por këto plane vështirë se mund të realizohen për shkak të rritjes së çmimit të energjisë. Në muajin shtator çmimi i energjisë elektrike në bursën hungareze HUPX, nga ku importon Kosova, ka qenë rreth 430 euro për megavat, krahasuar me rreth 150 euro sa ka kushtuar në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. "Nëse nuk ndërmerret diçka, bashkë me qeverinë, ne nuk mund të operojmë", paralajmëron

Vinarci. Nga ndërmarrja "Trepça" thonë se kanë propozuar një plan, i cili, sipas Vinarci, mund ta zgjidhë problemin me energji elektrike. "Kemi sipërfaqe që kemi konstatuar se mund të jepen në shfrytëzim për vendosjen e paneleve solare, ku mund të prodhohet energjia [elektrike]", thotë Vinarci. Ai nuk jep më shumë detaje rreth këtij plani, por thotë se është i realizueshëm. Trepça, në dekadat e fundit të shekullit të kaluar, llogaritej si një prej ndërmarrjeve më të mëdha jo vetëm në Kosovë, por edhe në territorin e atëhershëm të Jugosllavisë. Cilësohej si shtylla kryesore industriale e ekonomisë së Kosovës. Sipas të dhënave të institucioneve të Kosovës, nga viti 1945 deri në periudhën para

vitit 1990, nga minierat e Trepçës nxirreshin rreth 600 mijë tonë xehë në vit.

Rënia e prodhimit ka nisur në vitet '90 kur regjimi i atëhershëm i Serbisë ka vendosur masa të dhunshme në Kosovë, duke mbyllur gati të gjitha ndërmarrjet dhe institucionet në vend.

Trepçën e kanë përcjellë probleme edhe pas përfundimit të luftës në Kosovë më 1999. Ndërmarrja nuk ka arritur asnjëherë të vihet në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit.

Makineritë e vjetruara mbi 50 vjet dhe mungesa e mirëmbajtjes janë probleme të vazhdueshme.

Për ta rikthyer ndërmarrjen në funksion më të favorshëm të prodhimit kërkohen investime në makineri moderne dhe produktive, çka, deri më tash, nuk ka pasur.

Në fund të shtatorit, për shkak të një defekti me energji elektrike në minierën e Stantërgut, mbi 120 punëtorë kanë mbetur të ngujuar për një kohë në thellësi mbi 800 metra nën tokë.

Përfaqësues të sindikatës së punëtorëve të Trepçës kërkojnë vazhdimisht kushte më të mira për punëtorët. Kosova asnjëherë nuk ka bërë një analizë të hollësishme të vlerës reale të kombinatit metalurgjik, Trepça.

Drejtori i Trepçës në vitet '90, Burhan Kavaja, ka thënë në një intervistë të mëhershme për "Radion Evropa e Lirë", se një studim i bërë në vitin 1992 për të gjitha resurset natyrore të Kosovës, ka gjetur se potenciali material i Trepçës mund të jetë 85 miliardë dollarë amerikanë.

Qeveria subvencionon pajisjet efiçiente për ngrohje për qytetarë

PRISHTINË, 6 TETOR - Nga 6 tetori deri më 20 tetor qytetarët e Kosovës mund të aplikojnë për subvencionim të pajisjeve efiçiente për ngrohje nga qeveria. Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka bërë me dije në një konferencë për medie se për këtë skemë janë ndarë gjashtë milionë euro. Ajo ka thënë se përmes kësaj skeme synohet jo vetëm të ulët çmimin në fatura, por edhe të rriten gjasat për furnizim të rregullt me energji. "Secili veprim për kursim të energjisë është jo vetëm kursim për konsumatorët dhe buxhetin e shtetit, por edhe i rrit gjasat për furnizim të rregullt me energji, andaj i ftoj qytetarët të aplikojnë për këtë skemë dhe t'i shfrytëzojnë të gjitha mënyrat e mundshme për të kursyer energji elektrike gjatë

këtij dimri", u shpreh Rizvanolli. Përmes uljes së konsumit ajo ka thënë se po synohet të ulët nevoja për import, që mund t'i kushtojë Kosovës 316 milionë euro. Megjithatë, kjo shifër është bërë sipas parashikimeve për prodhim dhe çmimeve aktuale të cilat mund të ndryshojnë. Aplikimi për këtë skemë bëhet përmes platformës E-Kosova, ku fillimisht duhet të plotësohet një formular e pastaj të dorëzohet edhe fatura në mënyrë që të përfitohet nga subvencionimi. Për kaldajat me biomasa dru, pellet, briket - qeveria do të subvencionojë deri në 70 % të investimit, për pompat termike deri në 30 %, për kondicionerët efiçientë deri në 40 % dhe për stufat individuale me biomasa deri në 90 % për



qytetarët që përfitojnë nga skemat e ndihmës sociale dhe deri në 70 % për qytetarët e tjerë. E pyetur nëse këto masa kanë ardhur me vonesë pasi që shumë qytetarë kanë bërë investimet për këtë dimër,

Rizvanolli tha se me këto masa synohet të ndihmohen ata që nuk kanë pasur mundësi të bëjnë zgjidhje deri tani. "Masat që po i përkrahim shpresojmë se do të shfrytëzohen në radhë të parë nga familjet që s'kanë pasur

mundësi të bëjnë zgjidhje deri tani dhe këto duhet dhe janë targeti primar i secilës ndërhyrje të qeverisë", tha ajo. Qeveria e Kosovës ka paralajmëruar se në sezonin e dimrit do të ketë reduktime të energjisë për shkak të mungesës së kapaciteteve prodhuese për ta mbuluar kërkesën dhe çmimit të shtrenjtë të importit të rrymës. Ekzekutivi u ka bërë thirrje qytetarëve që ta kursejnë rrymën gjatë dimrit në mënyrë që niveli i reduktimeve të ulët. Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), me dy termocentralet, Kosova A dhe Kosova B, mund të prodhojë energji deri në 800 megavat në orë, kurse nevojat e konsumatorëve, në ditë dimri, arrijnë deri në 1 300 megavat në orë. Diferenca tjetër sigurohet nga importi.

Pse koha shkon përpara, dhe jo mbrapa?



Kur Isak Njutoni botoi librin e tij të famshëm "Principia" në vitin 1687, 3 ligjet e tij mbi lëvizjes e objekteve zgjidhën shumë probleme. Pa to, ne nuk mund të kishim shkuar dot në Hënë 282 vjet më vonë. Por këto ligje sollën në fizikë edhe një problem të ri, i cili nuk u trajtuar me shumë seriozitet dhe që i shqetëson ende sot kozmologët.

Problemi është se ligjet e Njutonit funksionojnë rreth 2 herë më mirë sesa mund ta prisnim. Ato përshkruajnë botën ku jetojmë çdo ditë – botën e njerëzve, lëvizjen e akrepave të orës – por ato janë gjithashtu shumë të mira për një botë në të cilën njerëzit ecin mbrapa dhe koha kthehet pas.

"Karakteristika më interesante e ligjeve të Njutonit, që nuk u vlerësua deri vonë, është se ato nuk bëjnë dallimin midis së kaluarës dhe së ardhmes. Por drejtimi i kohës është tipari më i dukshëm i saj, apo jo? Unë kam fotografi të së kaluarës, por nuk kam asnjë fotografi të së ardhmes" - thotë fizikani dhe filozofi teorik Shon Kerol, që e trajton natyrën e kohës në librin e tij të fundit me titull "Idetë më të mëdha në univers".

Problemi nuk kufizohet vetëm tek teoritë shekullore të Njutonit. Thujse të gjitha teoritë bazë të fizikës kanë funksionuar po aq mirë, duke shkuar sa par pas në kohë, thotë fizikanti Karlo Roveli i Qendrës për Fizikën Teorike në Marsejë, Francë, dhe autori i disa librave duke përfshirë "Rendi i kohës".

"Duke nisur nga Njutoni, dhe më pas me teoritë e Maksuell për

elektromagnetizmin, më pas me punën e Ajnshtajnit, dhe më vonë me mekanikën kuantike, teoritë e fushës kuantike, Relativitetin e Përgjithshëm dhe madje edhe gravitetin kuantik, nuk ka dallim mes të kaluarës dhe së ardhmes. Kjo na duket si diçka e habitshme, sepse dallimi është kaq i dukshëm për të gjithë ne" - thotë Roveli.

Siç thotë Marina Kortes, astrofizikante në Universitetin e Lisbonës: "Ka shumë pasoja që fillojnë me marrjen më seriozisht të pyetjes "Pse kalon koha"? Një pjesë e përgjigjes qëndron tek Big Bengu i ndodhur gati 14 miliardë vjet më parë. Një tjetër vjen nga ekstremi i kundërt, nga vdekja përfundimtare e Universit.

Por përpara se të nisim këtë udhëtim epik mbrapa dhe mbrapa përgjatë vijës kohore të Universit, ia vlen të ndalemi në vitin 1865. Gjatë shekullit XX-të, kur qymyri futej me lopatë nëpër furra për të gjeneruar energji përmes avullit, shkencëtarët dhe inxhinierët që shpresonin të zhvillonin motorë më të mirë, përqaftuan një sërë parimesh që përshkruanin marrëdhëniet midis nxehtësisë, energjisë dhe lëvizjes.

Atë vit në Gjermani, fizikani Rudolf Klausius deklaroi se nxehtësia nuk mund të kalojë nga një trup i ftohtë në një trup të nxehtë, nëse nuk ndryshon asgjë tjetër rreth tyre. Ai krijoi konceptin që e quajti "entropi" për të matur këtë sjellje të nxehtësisë.

Siç e thekson Roveli në librin e tij "Rendi i kohës", ky është i vetmi ligj bazë i fizikës që mund ta dallojë të

kaluarën nga e ardhmja. Për ta ilustruar këtë ligj, Roveli merr stilolapsin dhe e lëshon nga njëra dorë tek tjetra. "Arsyeja pse ndalon në dorën time është se ka pak energji. Më pas energjia kthehet në nxehtësi dhe më ngroh dorën. Dhe fërkimi ndalon zhvendosjen. Përndryshe, nëse nuk do të kishte nxehtësi, do të zhvendosej përgjithmonë atje-këtu, dhe unë nuk do ta dalloja dot të kaluarën nga e ardhmja" - shprehet ai.

Deri këtu, gjithçka duket shumë e qartë. Kjo derisa filloni të konsideroni se çfarë është nxehtësia në nivelin molekular. Dallimi midis gjërave të nxehta dhe atyre të ftohta, është se sa të trazuar janë molekulat e tyre. Në një motor me avull të nxehtë, molekulat e ujit janë shumë të shtypura, duke u përplasur me shpejtësi me njëra-tjetrën.

Të njëjtat molekula të ujit janë më pak të trazuar kur bashkohen në formën e kondensimit në xhamin e dritares. Këtu qëndron dhe problemi: kur e zmadhon krahasimin në nivelin molekular, për shembull një molekulë uji që përplasat dhe kapërcehet nga një tjetër, zhduket shigjeta e kohës.

Nëse do të shihnit një video mikroskopike të asaj përplasje, dhe më pas do ta kthenit mbrapsht, nuk do të ishte e qartë se cili drejtim ishte përpara dhe cili pas. Në shkallën më të vogël, fenomeni që prodhon nxehtësi – përplasjet e molekulave – është simetrik në kohë.

Kjo do të thotë se shigjeta e kohës nga e kaluar në të ardhmen

shfaqet vetëm kur bëni një hap prapa nga bota makroskopike në atë mikroskopike. Kjo dukuri u vu re për herë të parë nga fizikanti austriak Ludvig Bolcman. "Pra, drejtimi i kohës vjen nga fakti që ne shohim gjërat e mëdha, por nuk shohim detajet" - thotë Roveli.

Por nëse ekziston vërtet një shigjetë e drejtimit të kohës, nga ka ardhur ajo? "Përgjigja është e ngulitur në fillimet e Universit. Big Bengu kishte entropi të ulët dhe ende, 14 miliardë vjet më vonë ne po notojmë në pasojat e atij cunami që filloi pranë Big Bengut. Kjo është arsyeja pse koha ka një drejtim për ne sot" - deklaroi Kerol.

Shigjeta e kohës që lind nga entropia, na sjell më pranë të kuptuarit pse koha shkon vetëm përpara. Por mund të ketë më shumë shigjeta të kohës se kjo që njohim. Dhe për t'i kuptuar këto, duhet të kalojmë nga fizika tek filozofia. "Mënyrat se si ne e kuptojmë dhe përjetojmë kohën në mënyrë intuitive nuk duhet të merren lehtë" - thotë Xhenan Ismael, profesore e filozofisë në Universitetin e Kolumbias, Nju Jork. Nëse mendoni mbi përvojën tuaj me kohën, mund të jeni në gjendje të dalloni disa nga shigjetat psikologjike që përbëjnë një pjesë thelbësore të përvojës njerëzore. Një nga këto shigjeta është ajo që Ismaeli e quan "rrjedha e kohës".

"Nëse shihni botën, nuk përjetoni një paraqitje thjesht statike të gjendjes së menjëhershme të botës, pra si në një film të përbërë nga një numër kornizash statike çdo

sekondë. Ne e shohim drejtpërsëdrejti se bota po ndryshon" - thekson ajo.

"Kjo përvojë e rrjedhës së kohës është ndërtuar në perceptimin tonë. Shikimi nuk është aspak si një aparat filmi. Në fakt ajo që ndodh është se truri juaj mbledh informacion gjatë një periudhe kohore. Dhe e integron atë informacion në një mënyrë të tillë që në çdo moment, ajo që shihni është një llogaritje që ka bërë truri. Kështu ju jo vetëm shihni gjërat që lëvizin, por edhe sesa shpejt dhe në cilin drejtim po lëvizin. Ndaj gjatë gjithë kohës, truri juaj e integron informacionin në intervale kohore dhe ju jep rezultatin. Kështu në një farë mënyre jeni duke e parë kohën që ecë n" - shton Ismael.

Një veçori e dytë e kohës që Ismael e dallon nga rrjedha, të cilën ajo e quan "kalim i kohës".

Ideja e kalimit është e lidhur ngushtë me përvojat e orientuara nga koha, si kujtesa dhe pritshmëritë. Merrni shembullin e një martese apo ndonjë ngjarjeje të shumëpritur në jetë. Përvoja jonë e këtyre momenteve ka shumë shtresa – nga fazat e planifikimit të ndashëm, tek vetë intensiteti i ditës, dhe deri tek kujtimet që qëndrojnë me ne për vite. Në këto përvoja të ndryshme ka një drejtim: mënyra se si ne e parashikojmë një ngjarje në të ardhmen, është thelbësisht e ndryshme nga mënyra se si e kujtojmë atë kur ka kaluar.

Marrë me shkurtime nga "BBC Future" – Bota.al



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Sekretari gjeneral i FIBA Botës: FBK-ja është ndër federatat më aktive

“Ky është vit jubilar, pasi është 90-vjetori i themelimit të FIBA-s, ku po zhvillohen shumë aktivitete në mbarë botën dhe jam shumë i lumtur që sot gjendem në mesin tuaj. Federata e Basketbollit e Kosovës, edhe pse është pranuar që një kohë të shkurtër, është ndër më aktivet me ngjarje dhe organizime. Ju dëshiroj shumë suksese për të ardhmen”, ka thënë Andreas Zagklis

PRISHTINË, 6 TETOR - Sekretari gjeneral i FIBA Botës, Andreas Zagklis, të enjten e ka vizituar Kosovën. Njeriu i parë i basketbollit në botë është takuar me drejtuesit e FBK-së, Arben Fetahu, kryetar i FBK-së dhe Elvira Dushku, sekretare e përgjithshme e FBK-së. Zagklisi është njoftuar me stafin e FBK-së dhe ka parë nga afër zyrat se ku punojnë dhe çfarë pune bëhet për basketbollin e Kosovës. “Ky është vit jubilar, pasi është 90-vjetori i themelimit të FIBA-s, ku po zhvillohen shumë aktivitete në mbarë botën dhe jam shumë i lumtur që sot gjendem në mesin tuaj. Federata e Basketbollit e Kosovës, edhe pse është pranuar që një kohë të shkurtër, është ndër më aktivet me ngjarje dhe organizime. Ju dëshiroj shumë suksese për të ardhmen”, ka thënë Zagklis para stafit të FBK-së.

Më pas sekretari gjeneral i FIBA Botës, Andreas Zagklis, e ka vizituar edhe Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë. Drejtuesit e FBK-së e kanë njoftuar nga afër për kushtet në këtë palestër, ndeshjet që i zhvillojnë klubet prishtinase, por edhe Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll. Më pas, Zagklis, në shoqëri të drejtuesve të FBK-së, është takuar me krerët e Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), kryetarin Ismet Krasniqi dhe sekretarin e përgjithshëm Besim Aliti. Zagklisi ka kërkuar nga KOK-u mbështetje për FBK-në sa i përket zhvillimit të 3x3 në Kosovë, duke shpresuar se Kosova me 3x3 do të arrijë të kualifikohet në Kampionatin Botëror të 3x3 dhe kualifikimet e Lojërave Olimpikë të “Los Anxhelos 2028”. Drejtuesit e KOK-ut kanë theksuar se do ta mbështesin



Federatën e Basketbollit si në edukimin e trajnerëve, po ashtu për 3x3. Tashmë është formuar një grup punues në mes të KOK-ut dhe FBK-së për zhvillimin e 3x3 në Kosovë dhe janë duke pritur edhe mbështetjen nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), që ky sport shumë atraktiv të zhvillohet sa më shumë

dhe të jetë i suksesshëm në garat ndërkombëtare. Në fund të takimit, Andreas Zagklis ua ka dhuruar një top të basketbollit krerëve të KOK-ut me nënshkrim të tij, si dhe nga një fanellë të Përfaqësueses së Kosovës, ndërsa Zagklis ishte i pranishëm edhe në finalen e Superkupës Mbarëkombëtare, që

zhvillohet nga ora 20:00 në “Minatori” të Mitrovicës në mes të Tiranës dhe Trepçës. Ndërkohë sot (7 tetor) do të takohet me kryetarin e Prishtinës, Përparim Rama (nga ora 10:00 në komunën e Prishtinës) dhe me ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Kosovës, Hajrulla Çeku (nga ora 11:00 në MKRS).

Kosova bie për një pozitë në renditjen e FIFA-s, Shqipëria mbetet aty



Prishtinë, 6 tetor - FIFA e ka publikuar ranglistën e re për ekipet përfaqësuese. Kosova ka zhvilluar dy ndeshje në muajin shtator dhe ka pësuar ndryshime në renditje, por kësaj radhe ka rënë për një pozitë. “Dardanët” pësuan humbje 2-1 nga Irlanda e Veriut derisa mposhtën Qipron 5-1. “Dardanët” kanë rënë për një pozitë dhe tani ndodhen në vendin e 107 me 1187,01 pikë. Rezultate edhe më dobëta pati Shqipëria, ku u mposht në udhëtim 2-1 nga Izraeli dhe luajti baras 1-1 me Islandën,

përkundër që mysafirët ishin me 10 futbollistë në fushë. Por, përkundër se nuk arritën asnjë fitore, Shqipëria ka ruajtur pozitën e 66 me 1354,11 pikë. Në top-dhjetëshe nuk ka ndryshime të mëdha, pasi Brazili mbetet në pozitën e parë, vetëm Italia ka parakaluar Spanjën, duke u ngjitur në pozitën e gjashtë dhe me spanjollët në pozitën e shtatë. Pozitën e dytë e mban Belgjika, të tretën Argjentina, teksa pas tyre vijnë Franca, Anglia dhe Holanda, Portugalia dhe Danimarka që ndajnë pozitën tetë, nëntë dhe dhjetë.

Sot zhvillohen ndeshjet gjysmëfinale në Superkupën e femrave

PRISHTINË, 6 TETOR - Superkupa e Kosovës në basketboll të femrat pritet të dhurojë disa ndeshje mjaft interesante. Ndeshjet gjysmëfinale dhe finalja do të zhvillohen në qytetin e Pejës, ku do të ketë ndeshje të bukura të

parket dhe atmosferë të mirë sportive të femrat. Sfida e parë zhvillohet në mes të Penzës dhe Trepçës, ku vashat pejane janë favorite për të kaluar në finale, kurse takimi i dytë është ndërmjet Prishtinës dhe

Bashkimit. Kjo përballje pritet të jetë shumë interesante. Ndeshjet në mes të këtyre skuadrave kanë qenë interesante dhe kështu pritet të jetë edhe të premtën mbrëma. Finalja do të zhvillohet të dielën nga ora 20:00.

ORARI

Të premtën takohen:
16:00 Penza - Trepça
19:00 Prishtina - Bashkimi





Nr prot:390/22

Datë:06.10.2022

Mbështetur në Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.02/2016 për aktivitetet jashtë shkollore Gjimnazi "Hamdi Berisha" në Malishevë shpallë:

OFERTË PËR EKSKURSION

Gjimnazi "Hamdi Berisha" në Malishevë shpall ftesë për ofertë për zgjedhjen e agjencionit të udhëtimit për organizimin e Ekskursionit në Republikën e Shqipërisë me maturan të për vitin shkollor 2022/2023.

Nisja do të realizohet me datën: 19.10.2022 në ora: 07:00

Kohëzgjatja e ekskursionit do të jetë 4 bujtje/ 5 ditë, me pansion të plot. Në ekskursion do të marrin pjesë 363 nxënës.

Agjencioni duhet të plotësojë këto parakushte :

1. Agjencioni duhet të jetë i licencuar
2. Të ketë bërë kontrollin teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore
3. Të ketë numer të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e nxënësve, do të merret parasysh edhe viti i prodhimit të autobusëve,
4. Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendorë të ngasësve të autobusëve.
5. Agjencioni duhet të siguroj përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe dëshmitë (certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit.
6. Agjencioni duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e akreditimit të ushqimeve në Shqipëri të vulosur dhe nënshkruar nga pronari i hotelit
7. Kategorizimi i hoteleve do të bëhet në bazë të yjeve dhe sigurisë
8. Agjencioni duhet të prezantoj menyn ditore për secilen ditë të qëndrimit në Shqipëri të vërtetuar dhe nënshkruar nga pronari i hotelit
9. Kontrata në mes agjencionit dhe hotelit.
10. Një konfirmim të rezervimit të hotelit përkatës të vërtetuar mes kompanisë dhe hotelit nga data e caktuar (19.10.2022).
11. Licenca e ballos (Vallëzimit) ku nxënësit do të argëtohen e vulosur dhe nënshkruar nga pronari i hotelit. (jo më e vjeter se 30 ditë)
12. Hoteli ku bëhet akomodimi i nxënësve duhet të ketë shërbimin e sigurimit fizik profesional.
13. Vërtetimi i ATK-së
14. Agjencioni duhet të ofroj listen e shoferëve dhe puntorëve të deklaruar në ATK ,që do të marrin pjesë në ekskursion.
15. Agjencioni duhet të mbulojë shpenzimet e vizitave të nxënësve në monumentet historike.

Kriteret për përzgjedhjen e kompanisë janë të përcaktuara në bazë të Udhëzimit Administrativ të Masht-it, Nr.02/2016

Ofertat të cilat nuk i përbushin kriteret e kërkuara nuk do të merren në shqyrtim.

Afati i aplikimit është 7 ditë nga dita e shpalljes në gazetën zyrtare

Ofertat pranohen në zyrat e DKA-së në Malishevë.

Hapja e ofertave do të bëhet në ditën e fundit të aplikimit duke filluar nga ora 14:00, në shkollë.

Malishevë

06.10.2022

Gjimnazi "Hamdi Berisha" Malishevë
KDSH



Kompania Regionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar në ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas nenit 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ Nr. 07 / 2017, Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë Shpall Konkurs publik për këtë vende punës :

KONKURS

Pozita : PUNËTORI FIZIKË- / NË MBLEDHJEN E MEDHURINAVE

Vendi i punës Pejë (4pozita)

Kontrata kohë të pa caktuar

Puntori ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- 1.Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e hedhurinave.
- 2.Mbledh hedhurinat dhe bënë zbrazjen e Kontenjerve dhe mjeteve tjera për hedhurina apo çesëve nga shfrytëzuesit të shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror.
- 3.Pas zbrazjes së Kontenjerve dhe mjeteve tjera, është i obliguar t'i kthejë ato në vende të caktuara dhe për to të ketë kujdesë.
- 4.Është përgjegjës për kryerjen e punëve në mënyrë efikase dhe kualitative, për sjellje korrekte me qytetarët-shfrytëzuesit e shërbimeve.
- 5.Kryen edhe punë tjera me urdhëres të Kryepuntorit dhe Eprorit
- 6.Për punën e vetë i përgjigjet drjtëpërdrejtë Kryeshefit Ekzekutiv

Kualifikimi:

- Shkolla e mesme-
- te ketë përvojë pune.
- Aftësia të mir komunikimi

Mënyra e Aplikimit: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në ndërtesën e Ndërmarrjes "Ambienti" SH.A Rr Xhem Sadrija pn në Pejë. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në pliko të mbyllur në të cilin duhet të shkruhet pozita për të cilën aplikon. Data e fundit për aplikim është më: 28.10.2022 ora 16:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm në kopje pasi të njëjtat nuk ju kthehen. Dokumentet origjinale mund të kërkojnë, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Cyber Agent" SH.P.K. me pronar Fetije Hyseni Zahiri Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811945750 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Cyber Agent" D.O.O. sa vllasnikum Fetije Hyseni Zahiri Gnilan, donelo odluku o prestani rada sa nr. 811945750 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Cyber Agent" L.L.C. with owner Fetije Hyseni Zahiri Gnilane, has come to the decision to quit its business: 811945750 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC COLA
Columbus, Georgia, USA
Since 1908